



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština - Assembly

Legjislatura III

TRANSKRIPT

NGA SEANCA PLENARE E JASHTËZAKONSHME SOLEMNE E KUVENDIT TË
KOSOVËS ME RASTIN E SHPALLJES SË PAVARËSISË, TË MBAJTUR MË 17
SHKURT 2008

TRANSKRIPT

SA VANREDNE SVEÇANE PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA
POVODOM PROGLAŠENJA NEZAVISNOSTI, ODRŽANE 17 FEBRUARA 2008.
GODINE

SHKURT – FEBRUAR
2008

Seanca filloi punën në orën 15,00.

Seancën e drejtoi zoti Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit të Kosovës.
Bashkëkryesues ishin zoti Xhavit Haliti dhe zoti Sabri Hamiti, anëtarë të Kryesisë së Kuvendit.

(Duartrokitje)

KRYETARI I KUVENDIT, JAKUP KRASNIQI:

Kosova po hap sot një faqe të re të historisë dhe po ndërron hartën politike të Evropës.

Duke lënë pas kujtimet e hidhura të urrejtjes e të konflikteve tragjike që i përjetuam, ne po hyjmë në epokën e pavarësisë, të paqes dhe të përparimit të vendit tonë.

Paqe dhe liri të vërtetë mund të ketë vetëm midis të barabartëve. Kosova e pavarur do të jetë atdheu i qytetarëve të barabartë e të lumtur, duke u ngritur mbi themelet e vlerave më të mira të traditës së saj dhe sipas parimeve të demokracisë moderne.

Brezi i sotëm i Kosovës ka privilegj të veçantë për kthesën e madhe historike që i bën nder, por bashkë me të ka edhe përgjegjësinë e lartë të ndërtimit demokratik e evropian të atdheut dhe të brezave që do të na trashëgojnë.

Zotimi ynë solemn për Kosovën shtet demokratik është kontrata me qytetarët e saj dhe partneriteti me bashkësinë ndërkombëtare, është premtimi i përkushtimit jetësor për vlerat më të përparura e themeltare të shoqërisë së sotme njerëzore.

Kosova, asnjëherë në jetën e saj nuk ka pasur miq sa ka sot. Por, nesër do të ketë edhe më shumë. Kultura dhe rendi demokratik, shteti ligjor, përkushtimi paqekrijues, fqinjësia e mirë dhe fryma e dialogut, respekti dhe besimi - do të jenë baza e zgjerimit të miqësisë dhe të bashkëpunimit e të partneritetit.

Shfrytëzoj këtë rast solemn të shpreh ndjenjat e përlules së popullit të Kosovës ndaj të gjithë atyre që u flijuan në altarin e lirisë së Kosovës.

Me respekt të veçantë përshëndes të gjithë miqtë tanë që me përkushtim ndihmuan Kosovën në çastet vendimtare dhe historike.

Populli shqiptar dhe qytetarët e Kosovës do t'u jenë mirënjohës për jetë.

Në këtë ditë të shënuar, ndjehem i nderuar të përshëndes përfaqësuesin e familjes së madhe Jashari – zotin Rifat Jashari.

(Duartrokitje)

Familja Jashari është përfaqësuese e të gjitha flijimeve për liri të popullit shqiptar, është institucioni më shumë se moral që ka dhe do të ketë Kosova sot dhe me mot.

I nderuari zoti President i Kosovës,
 I nderuari zoti Kryeministër i Kosovës,
 Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,
 Të nderuar përfaqësues të prezencës ndërkombëtare në Kosovë,
 Të nderuar miq dhe të ftuar,
 Të nderuar qytetarë të Kosovës dhe bashkatdhetarë kudo që ndodheni,
 Zonja dhe zotërinj,

Kam kënaqësinë që në emër të Kuvendit të Kosovës dhe në emrin tim personal t'ju përsëris ju dhe të gjithë ata që po na përcjellin kudo në botë në këto çaste historike për të ardhmen e popullit të Kosovës!

(Duartrokitje)

Të nderuar deputetë,
 Mirë se keni ardhur në Seancën plenare të jashtëzakonshme solemne më 17 shkurt 2008, në orën 15,00.

Kam nderin që para jush të paraqes rendin e ditës.

Për pikën e parë të rendit të ditës kemi:

DEKLARATËN E PAVARËSISË

(Duartrokitje)

Për pikën e dytë të rendit të ditës kemi:

MIRATIMIN E SIMBOLEVE SHTETËRORE

Në sallë janë të pranishëm 104 deputetë.

Lus deputetët, që me ngritjen e dorës, të deklarojnë për miratimin e rendit të propozuar të ditës.

Faleminderit!

A ka ndonjë “kundër”? Nuk ka.

Konstatohet se Kuvendi, me vota unanime, pa asnjë votë “kundër”, miratoi rendin e ditës.

Tani në sallë janë të pranishëm 109 deputetë.

Ftoj Kryeministrin e Kosovës, zotin Hashim Thaçi, që ta arsyetojë kërkesën për seancë të jashtëzakonshme dhe solemne.

KRYEMINISTRI I KOSOVËS, HASHIM THAÇI:

I nderuar zoti Kryetar,
 President i Kosovës,
 Të nderuar ministra,
 Të nderuar deputetë,
 Kryetar të partive politike,
 Të nderuar mysafirë – ndërkombëtarë, vendorë,
 E nderuara familje Jashari,
 Të nderuar përfaqësues, mysafirë të komuniteteve fetare,
 Të nderuar të gjithë ju kontribuues për këtë rend të ditës të seancës së sotme të jashtëzakonshme,

Sot, në bashkëpunim me Presidentin e Kosovës, si Kryeministër i Kosovës, kam kërkuar zyrtarisht nga Kryetari i Parlamentit – zoti Krasniqi, që ta thërret seancën e jashtëzakonshme me dy pika të rendit të ditës.

Ftesa për seancë të jashtëzakonshme është bërë në përputhshmëri me Kornizën Kushtetuese të Kosovës dhe kërkesa jonë ka qenë për dy pika të rendit të ditës:

1. SHPALLJA E PAVARËSISË SË KOSOVËS, dhe
2. NXJERRJA E SIMBOLEVE SHTETËRORE TË KOSOVËS

Faleminderit zoti Kryetar për thirrjen me urgjencë dhe aprovimin e menjëhershëm nga Kryesia e Parlamentit dhe për miratimin e këtij rendi të ditës. Prandaj, të vazhdojmë.

I nderuari Kryetar i Kuvendit,
 Të nderuar deputetë,
 I nderuari President,
 Të nderuar mysafirë, bashkëqytetarë të nderuar të Kosovës,

Këtë ditë e kemi pritur gjatë. Shumë njerëz kanë dhënë aq shumë për ta bërë këtë realitet, këtë ditë të madhe – Ditën e Pavarësisë së Kosovës.

Sot, ne nderojmë ata që na kanë nderuar neve me sakrificën e tyre për liri e shtet. Ne i mbajmë në mend dhe i respektojmë emrat dhe veprat e tyre. Kujtimin për ta ne e ruajmë përgjithmonë në zemrat tona.

Ne iu jemi mirënjohës miqve dhe aleatëve tanë në vend dhe jashtë vendit, të cilët na kanë ndihmuar të mbërrijmë bashkërisht deri këtu.

I përshëndes të gjithë ata që janë sot këtu me ne, ndërsa atyre që janë duke na shikuar në këto momente iu shpreh mirënjohjen më të thellë, respektin më të lartë në emër të institucioneve dhe të popullit tim.

Kjo ditë erdhi! E nga sot e tutje, Kosova është krenare, e pavarur, sovrane dhe e lirë!

Familja ime, sikurse edhe tuajat dhe të gjitha familjet në tërë Kosovën, nuk u luhatën kurrë dhe nuk humbën asnjëherë besimin në ne, besimin në zot, në drejtësi dhe në fuqi.

Duke filluar me vëllain që la familjen e tij dhe shkoi për të luftuar, nga bujku që la tokën e tij pa mbjellë, nga burrat dhe gratë që hapën portat e tyre dhe mësuan fëmijët tanë e deri tek studentët, të cilët u ngritën, si gjithmonë, dhe thanë – mjaft!

Të gjithë atyre që janë kthyer për të ndërtuar një jetë më të mirë për fëmijët e tyre, ne nuk humbëm kurrë besimin në ëndrrën se një ditë ne do të qëndrojmë në mesin e shteteve të lira, të pavarura të botës demokratike.

Të gjithë ne, së bashku, e sollëm Kosovën në këtë moment dhe të gjithë duhet të jemi shumë, shumë krenarë.

Ashtu sikur prindërit dhe gjyshërit e mi, që më mësuan mua për sakrificë dhe çka do të thotë liri, nga ju kërkoj që të flisni me fëmijët, nipat dhe mbesat tuaja dhe t'ua shpjegoni domethënien e ditës së sotme. Ka qenë rrugë e gjatë, e vështirë, e sakrificave por edhe e fitores.

Barteni këtë rrëfim tek brezat e tjerë për gëzimin dhe krenarinë që ndjejmë ne sot dhe mos harroni asnjëherë t'ua përkujtoni atyre që t'i kujtojnë sakrificat e mëdha të brezave që ishin para nesh.

Kosova, në vitet e ardhshme do të përballet me sfida të shumta.

Por, asnjë sfidë nuk do të na zmbraps nga ecja jonë përpara, me një frymë të bashkuar si popull i bashkuar, me vizion politik, të qartë – properëndimor.

Sfidat tona, që nga ekonomia, arsimit dhe shëndetësia, infrastruktura dhe integrimi evropian – janë sfida të mëdha, por nuk mund t'i bëjnë ballë frymës pozitive të qytetarëve tanë dhe fatit tonë.

Kosova, populli dhe territori janë bashkuar sot në një moment historik për të përmirësuar jetërat e çdo qytetari brenda kufijve tanë, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike.

Shpresat tona nuk kanë qenë asnjëherë më të mëdha. Besimi ynë asnjëherë nuk ka qenë më i madh. Populli i Kosovës asnjëherë nuk ka qenë më i bashkuar. Ëndrrat tona janë të pakufishme. Kosova asnjëherë nuk ka pasur përkrahje më të madhe ndërkombëtare.

Sfidat para nesh janë të mëdha, por asgjë nuk mund të na ndalë nga ecja jonë përpara – drejt çasteve të reja historike, të cilat, historia e re i ka ndarë për ne dhe ne bashkërisht po e bëjmë historinë e re.

Sot, e gjithë bota është me ne dhe ne po bëhemi pjesë e barabartë e botës demokratike. Ne po bëhemi pjesë e barabartë e botës, të cilën e meritojmë.

Deri më tash kemi bërë shumë për të garantuar zotimin tonë para komuniteteve.

Në këtë ditë historike, të nderuar deputetë, dëshiroj të rikonfirmoj gatishmërinë tonë politike për të krijuar kushte të nevojshme, për respektimin dhe mbrojtjen e komuniteteve dhe për të përmirësuar edhe më shumë raportet midis tyre në Kosovën e re.

Kushtetuta dhe ligjet tona do të pasqyrojnë këtë së bashku me një strategji ndërinstitucionale në të gjitha nivelet e shtetit tonë të ri.

Këto zotime tona, do të mishërohen në tri elemente kryesore:

E para, garantimi i fuqishëm dhe i pakthyeshem me ligj i të drejtave të barabarta të të gjithë pjesëtarëve të komuniteteve në Kosovë.

E dyta, krijimi i mekanizmave të përhershëm për të garantuar që komunitetet të luajnë një rol të plotë dhe aktiv në zhvillimin e së ardhmes së vendit tonë, dhe

E treta, është përgjegjësia jonë për të marrë masa efektive dhe të menjëhershme për të siguruar që zotimet tona të rezultojnë me ndryshime pozitive për të gjithë ata që jetojnë në Kosovë, e në veçanti për pjesëtarët e komuniteteve.

Kushtetuta jonë parasheh se Kosova është shtet i të gjithë qytetarëve të saj. Nuk ka hapësirë për frikësim, diskriminim ose trajtim jo të barabartë për askënd. Ne po ndërtojmë Kosovën me të drejta të barabarta për të gjithë, me mundësi të barabarta për të gjithë.

Çdo praktikë diskriminuese do të çrrënjohet nga institucionet tona shtetërore. Çdo praktikë diskriminuese do të çrrënjohet nga vetë shoqëria jonë. Në Kosovë do të ketë vetëm tolerancë, mirëkuptim, bashkëjetesë, solidaritet dhe progres.

Në vend të kësaj, të gjithë pajtohen se shumëllojshmëria sjell përfitime pozitive për të gjithë.

Të nderuar deputetë,

Dragi sugradjani,

Današnji dan označava kraj jednog dugog procesa.

Ovo je kraj zadnjih pretnji i zabluda da će Kosovom ikada više vladati Beograd.

Sami Kosovari, svih etničkih, verskih i jezičkih pripadnosti će zajedno nositi svoju odgovornost u svojoj zemlji.

Mi činimo Kosovo nezavisnim sa ciljem da slobodu i ostale blagodeti naše zemlje uživaju svi gradjani.

Neka ovo bude dan novog početka!
Neka ovaj dan označi početak bolje budućnosti za sve naše građane države Kosova!

I nderuari Kryetar i Kuvendit,
I nderuari President,
Të nderuar deputetë,
Të nderuar mysafirë,
Bashkëqytetarë të nderuar të Kosovës, kudo që jeni, në diasporë,

Kosova po sjell vendimin historik. Kosova po e shpall pavarësinë e saj në përputhje me propozimin gjithëpërfshirës të Presidentit Ahtisari.

Pavarësia e Kosovës shënon fundin e shpërbërjes së ish Jugosllavisë. Zbatimi i dispozitave të Ahtisarit, të cilat janë inkorporuar në Kushtetutën e Kosovës, janë prioritet nacional për ne, për të gjithë, për institucionet dhe për popullin e Kosovës.

Kuvendi i Kosovës do t'i miratojë shpejt të gjitha ligjet kryesore që dalin nga dokumenti i Ahtisarit në ditët në vijim.

Të nderuar deputetë,
Kosova çmon rolin të cilin e ka luajtur Organizata e Kombeve të Bashkuara në rindërtimin e Kosovës dhe ndërtimin e institucioneve tona demokratike. Presim të punojmë me Organizatën e Kombeve të Bashkuara për të avancuar përpjekjet tona të përbashkëta për paqen, sigurinë dhe zhvillimin demokratik.

Gjithashtu, ne mirëpresim misionin e ri ndërkombëtar, të udhëhequr nga Bashkimi Evropian, i cili do të na ndihmojë në zhvillimin tonë demokratik dhe do të mbikëqyrë zbatimin e planit të Ahtisarit, që tanimë është plan i Kosovës.

Me këtë rast, dua t'ju siguroj të gjithë juve, përmes zërit të institucioneve të Kosovës, vullnetit tuaj, dua t'iu dërgoj mesazhe dhe t'iu siguroj fqinjët tanë se Kosova do të bëjë çmos që të vendosë dhe mbajë raporte të mira me të gjitha vendet fqinje. Ne aspirojmë të kemi raporte të mira të ndërsjella në interesin e përbashkët edhe me Serbinë, me besimin se kjo është në interesin tonë të përbashkët dhe investimeve të miqve tanë për paqe dhe stabilitet në rajon.

Që nga sot, Kosova do të jetë shtet demokratik dhe shumetnik i të gjithë qytetarëve të saj në rrugëtimin e saj të shpejtë drejt integriteteve euroatlantike. Ju faleminderit! Faleminderit, zoti Kryetar!

(Duartrokitje)

KRYETARI I KUVENDIT, JAKUP KRASNIQI:
Faleminderit, zoti Kryeministër! Fjalën e ka Presidenti i Kosovës, zoti Fatmir Sejdiu.

PRESIDENTI I KOSOVËS FATMIR SEJDIU:

I nderuar Kryetar i Kuvendit të Kosovës,
E nderuara Kryesi,
I nderuar zoti Kryeministër, Hashim Thaçi,
Të nderuar deputetë dhe ministra,
E nderuara familje e Presidentit Rugova,
E nderuara familje Jashari,

(Duartrokitje)

Të nderuar përfaqësues të institucioneve të Kosovës,
Përfaqësues të misioneve diplomatike,
Përfaqësues të shkencës, të kulturës, të kulteve,
Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Poštovani poslanici,
Poštovani gradjani Kosova,

Zonja dhe zotërinj,
Dita e sotme e ndanë historinë e Kosovës në dysh: në epokat para dhe pas pavarësisë.

Pavarësinë e Kosovës e kanë krijuar breza të tërë me veprën e tyre jetësore, me punë të palodhshme dhe me sakrificat që kanë bërë.

Pavarësinë tonë po e shpallim para dhe me bekimin e botës, në mes miqsh tanë që u gjetën pranë nesh gjatë dekadave e sidomos para një dekade, kur e keqja kishte përfshirë këtë pjesë të Ballkanit. Po të njëjtit miq ishin me ne edhe gjatë rimëkëmbjes së pasluftës, rindërtimit të vendit të shkatërruar nga lufta dhe okupimi. Janë edhe sot, janë edhe nesër.

Sot, kujtojmë shumë sakrifica që i kanë paraprirë kësaj dite të jashtëzakonshme. I kujtojmë nënat dhe baballarët të cilët përjetuan vështirësi të papërshkrueshme në mënyrë që bijtë dhe bijat e tyre të mund të jetonin të lirë. Sot, kujtojmë Presidentin Ibrahim Rugova, udhëheqësin e madh dhe themelтарin e shtetit tone, i cili e nxori Kosovën nga kaosi në rend demokratik. Sot, kujtojmë Adem Jasharin dhe Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës që e çuan tutje vullnetin e popullit të Kosovës për të qenë të lirë. Po ashtu kujtojmë edhe fqinjët tanë të gjitha përkatësive etnike, ideologjike e religjioze të cilët na dolën në ndihmë gjatë viteve të represionit dhe luftës. I kujtojmë të gjitha këto jo në shenjë hakmarrjeje për të kaluarën e dhunshme, por për të ndërtuar një të ardhme plot besim që do të ofrojë ambient për pajtim dhe falje.

Këto ngjarje të madhërishme të historisë sonë, sakrificat tona, si dhe shpresat dhe arritjet tona – na kanë sjellë sot këtu për të shpallur pavarësinë tonë. Kjo shpallje e pavarësisë është vullnet i popullit. Është rrjedhojë morale dhe logjike e historisë sonë dhe është në pajtueshmëri të plotë me rekomandimet e të dërguarit special - Presidentit Marti Ahtisari.

Pavarësia e Kosovës shënon fundin e procesit të gjatë të shpërbërjes së Jugosllavisë. Pas dy vitesh angazhimi në negociata të mirëfillta mbi statusin me Beogradin dhe përkundër angazhimit serioz dhe konstruktiv të Ekipit të Unitetit të Kosovës, arritja e një zgjidhjeje të pranueshme për dy palët nuk ishte e mundshme. Prandaj, u desh të vepronim për t'i ofruar popullit tonë një perspektivë të qartë me qëllim të avancimit të zhvillimit tonë politik, shoqëror dhe ekonomik.

Vizioni ynë për Kosovën është shumë i qartë. Dëshirojmë që Kosovën ta ndërtojmë mbi parimet fundamentale demokratike. Kjo do të thotë se Kosova do të jetë një shtet demokratik, shumetnik, i integruar në rajon, me marrëdhënie të mira fqinjësore me shtetet përreth, një shtet që lëviz shpejt drejt anëtarësimit të plotë në Bashkësinë Euro-atlantike. Populli i Kosovës është përcaktuar dhe dëshiron një të ardhme evropiane për vendin e vet.

Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës në mars të vitit të kaluar ka marrë edhe përkrahjen e Kuvendit të Kosovës. Kjo pako iu jep serbëve por edhe pakicave tjera: turqve, boshnjakëve, romëve, ashkalinjve dhe egjiptasve garanci të fuqishme për mbrojtjen e të drejtave të tyre kulturore e politike, që në shumë pika tejkalojnë edhe standardet më të avancuara ndërkombëtare për të drejtat e pakicave. Kushtetuta e Republikës së Kosovës u garanton komuniteteve pakicë pjesëmarrje të gjithanshme dhe kuptimplote në vendimmarrje.

Të nderuar pjesëmarrës të kësaj seance historike të Kuvendit të Kosovës,

Prioritet nacional për Republikën e Kosovës në javët dhe muajt e ardhshëm është zbatimi i plotë i Planit të Ahtisarit. Shumë shpejt synojmë të miratojmë ligjet dhe Kushtetutën e re të Kosovës e cila mishëron edhe parimet e Ahtisarit. E gjithë kjo do të pasohet me veprime konkrete në terren për zbatimin e dispozitave që përmban plani i Presidentit Ahtisari.

Kosova, me aktin e sotëm, po ashtu po merr përgjegjësitë që i takojnë si shtet. Në të njëjtën kohë, Kosova rithekson përkushtimin për bashkëpunim të ngushtë me bashkësinë ndërkombëtare për ndërtimin e një shteti në pajtim me normat dhe parimet më të avancuara të demokracisë. Për këtë qëllim Kosova mirëpret vendosjen e pranisë civile ndërkombëtare, e cila do të mbështesë zhvillimin e mëtejshëm demokratik të vendit tonë, por edhe do të mbikëqyrë zbatimin e Planit të Ahtisarit. Në veçanti, vlerësojmë gatishmërinë e Bashkësisë Evropiane për të marrë një rol më të madh në Kosovë. Po ashtu, mirëpresim vazhdimin e pranisë ushtarake të trupave të NATO-s. Zotohemi se do të bashkëpunojmë ngushtë me përfaqësuesit civilë dhe ushtarakë në Kosovë.

Jemi të vetëdijshëm se pjesëtarët e komuniteteve pakicë në Kosovë e shikojnë pavarësinë me frikë dhe skepsë. Ne do të bëjmë çmos që të sigurohemi se të drejtat, kultura dhe prona e tyre do të respektohen në mënyrë rigorozë në Kosovën e pavarur.

Poštovani gradjani Kosova,
Poštovani poslanici,

Još jednom želim da iskoristim ovu svečanu priliku da ponovo pozivam sve građane Kosova, pre svega građane Srpske zajednice na Kosovu da daju svoj doprinos u zajedničkoj izgradnji jednog Evropskog Kosova u kojem će se svaki građanin osećati u svojoj kući. Kosovo je podjednako vaša kuća i vaša domovina. Vaša prava i prava pripadnika drugih zajednica u nezavisnom Kosovu biće stalna obaveza naših državnih institucija. Srpsko kulturno i religiozno nasledje biće potpuno zaštićeno. Vaš etnički i jezički identitet biće potpuno poštovan, a to ćemo ostvariti zajedničkim radom u svakodnevnom životu i u institucijama Kosova.

Të nderuar deputetë,

Duam të theksojmë fuqishëm se Kosova dëshiron marrëdhënie të fqinjësisë së mirë edhe me Serbinë mbi bazën e respektimit të ndërsjellë. Shpresojmë se synimi ynë për të normalizuar marrëdhëniet me Beogradin sa më shpejt që të jetë e mundur do të përkrahët edhe nga Serbia.

Jemi mirënjohës për rolin dhe punën që ka bërë Organizata e Kombeve të Bashkuara në rindërtimin e Kosovës së pasluftës. Organizata e Kombeve të Bashkuara do të vazhdojë të luajë një rol në Kosovë për aq kohë sa Rezoluta 1244 do të jetë në fuqi. Do të vazhdojmë të bashkëpunojmë me OKB-në për të avancuar qëllimet tona të përbashkëta për paqe, siguri dhe zhvillim demokratik të Kosovës deri në anëtarësimin e plotë të Kosovës në këtë organizatë prestigjioze.

Integrimi ynë do të rrjedhë natyrshëm, sepse me vlerat e veta Kosova kulturalisht i ka takuar kësaj familjeje gjithnjë, por tashti, në rrethanat e reja, Kosovës i duhet integrimi politik për të krijuar mundësi të reja në mënyrë që resurset njerëzore dhe natyrore të vihen në shërbim të zhvillimit të gjithanshëm shoqëror dhe ekonomik të vendit tonë.

Zonja dhe zotërinj,

Republika e Kosovës sot kërkon përqaftimin e botës. Ndërsa presim njohje të shpejtë nga shumë vende të botës, me pietet të veçantë kujtojmë shumë personalitete të mëdha botërore që qëndruan përkrah popullit të Kosovës gjatë dekadave, e sidomos gjatë orëve më të vështira të tij.

Populli ynë do të dijë t'u jetë përjetësisht mirënjohës Shteteve të Bashkuara të Amerikës, vendeve të Bashkimit Evropian, NATO-s dhe vendeve të tjera të botës demokratike për përkrahje të pazëvendësueshme për vendin tonë të dashur – për Kosovën.

Zoti e bekoftë Kosovën dhe popullin e saj!

Zoti e bekoftë Republikën e Kosovës!

Zoti i bekoftë të gjithë miqtë e Kosovës!

(Duartrokitje)

KRYETARI I KUVENDIT, JAKUP KRASNIQI:

Ju faleminderit, zoti President!

Ftoj Kryeministrin e Kosovës, zoti Hashim Thaçi, që të paraqesë Propozimdeklaratën e Pavarësisë.

(Duartrokitje)

Ftoj të pranishmit të qëndrojnë këmbë!

KRYEMINISTRI I KOSOVËS, HASHIM THAÇI:

I nderuari zoti Kryetar i Kuvendit,

I nderuari President,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar mysafirë,

E nderuara familja Jashari,

E nderuara familje Rugova,

Faleminderit, Shtete të Bashkuara të Amerikës, Bashkim Evropian dhe NATO! Respekt!

Tani, më lejoni që, duke ndjerë rrahje të zemrës së stërgjyshërve tanë, në veshët tanë, unë me nderin dhe privilegjin më të madh do ta lexoj Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

(Duartrokitje)

DEKLARATË

PËR PAVARËSINË E KOSOVËS

Të mbledhur në Seancë solemne plenare të jashtëzakonshme, më 17 shkurt 2008, në kryeqytetin e Kosovës,

Duke iu përgjigjur thirrjes së popullit për të ndërtuar një shoqëri që respekton dinjitetin njerëzor dhe afërmon krenarinë dhe synimet e qytetarëve të saj;

Të zotuar për t'u përballur me trashëgiminë e dhembshme të së kaluarës së afërt dhe në frymë të pajtimit dhe të faljes;

Të përkushtuar ndaj mbrojtjes, promovimit dhe respektimit të diversitetit të popullit tonë;

Duke riafirmuar dëshirën tonë për t'u integruar plotësisht në familjen Euroatlantike të demokracive;

Duke vërejtur se Kosova është një rast i veçantë që del nga shpërbërja jokonsensuale e Jugosllavisë dhe nuk është precedencë për cilëndo situatë tjetër;

Duke rikujtuar vitet e konfliktit dhe të dhunës në Kosovës, që shqetësuan ndërgjegjen e të gjithë popujve të civilizuar;

Duke qenë mirënjohës ndaj gjithë botës që ndërhyri me 1999, duke hequr në këtë mënyrë qeverisjen e Beogradit mbi Kosovën dhe duke vendosur Kosovën nën administrimin e përkohshëm të Kombeve të Bashkuara;

Duke qenë krenarë që Kosova që atëherë ka zhvilluar institucione funksionale shumetnike të demokracisë, që shprehin lirisht vullnetin e qytetarëve tanë;

Duke rikujtuar vitet e negociatave të sponsorizuara nga ndërkombëtarët ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës mbi çështjen e statusit tonë të ardhshëm politik;

Duke shprehur keqardhje që nuk u arrit asnjë rezultat i pranueshëm për të dy palët, përkundër angazhimit të mirëfilltë të udhëheqjes kosovare dhe rolit të rëndësishëm ndërkombëtar;

Duke rikonfirmuar se rekomandimet e të dërguarit special të Kombeve të Bashkuara, Presidentit Marti Ahtisari, i ofrojnë një kornizë gjithëpërfshirëse për zhvillimin e saj të ardhshëm, janë në një vijë me standardet më të larta evropiane për të drejtat e njeriut dhe qeverisjen e mirë;

Duke qenë të vendosur që të shohim statusin tonë të zgjidhur në mënyrë që t'i jepet popullit tonë qartësi për të ardhmen dhe të shkohet përtej konflikteve të së kaluarës dhe të realizohet potencial i plotë demokratik i shoqërisë sonë;

Duke nderuar të gjithë burrat dhe gratë që bënë sakrifica të mëdha për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për Kosovën,

1. Ne, udhëheqësit e popullit tonë, të zgjedhur në mënyrë demokratike, nëpërmjet kësaj

D E K L A R A T E

SHPALLIM KOSOVËN SHTET TË PAVARUR DHE DEMOKRATIK

(Duartrokitje)

Kjo shpallje pasqyron vullnetin e popullit tonë dhe është në pajtueshmëri të plotë me rekomandimet e të dërguarit special të Kombeve të Bashkuara, Marti Ahtisari, dhe propozimin e tij gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës.

Ne e shpallim Kosovën Republikë demokratike, laike dhe shumetnike, të udhëhequr nga parimet e jodiskriminimit dhe të mbrojtjes së barabartë sipas ligjit.

Ne do të mbrojmë dhe promovojmë të drejtat e të gjitha komuniteteve në Kosovë dhe do të krijojmë kushte të nevojshme për pjesëmarrjen e tyre efektive në proceset politike dhe vendimmarrëse.

Ne pranojmë plotësisht obligimet për Kosovën që përmban plani i Ahtisarit dhe mirëpresim kornizën që ai propozon për të udhëhequr Kosovën në vitet në vijim.

Ne do t'i zbatojmë plotësisht ato obligime dhe miratimin prioritar të legjislacionit, të përfshirë në Aneksin 12 të tij, veçanërisht atë që mbron dhe promovon të drejtat e komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre.

Ne do të miratojmë, sa më shpejt që është e mundur, një Kushtetutë që mishëron zotimin tonë për të respektuar të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të gjithë qytetarëve tanë, posaçërisht ashtu siç definohej me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Kushtetuta do të përfshijë të gjitha parimet relevante të Planit të Ahtisarit dhe do të miratohet nëpërmjet një procesi demokratik dhe të kujdesshëm.

Ne mirëpresim mbështetjen e vazhdueshme të bashkësisë ndërkombëtare për zhvillimin tonë demokratik nëpërmjet pranive ndërkombëtare të themeluara në Kosovë në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në vitin 1999.

Ne ftojmë dhe mirëpresim një prani ndërkombëtare civile për të mbikëqyrur zbatimin e Planit të Ahtisarit dhe një mision për sundimin e ligjit, të udhëhequr nga Bashkimi Evropian.

Ne, po ashtu, ftojmë dhe mirëpresim NATO-n që të mbajë rolin udhëheqës në praninë ndërkombëtare ushtarake dhe të zbatojë me përgjegjësi të dhënë sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të vitit 1999, dhe Planit të Ahtisarit deri në atë kohë kur institucionet e Kosovës do të jenë në gjendje të marrin këto përgjegjësi.

Ne do të bashkëpunojmë plotësisht me këto prani në Kosovë për të siguruar paqen, përparimin, stabilitetin për të ardhmen e Kosovës.

Për arsye të kulturës, të gjeografisë dhe të historisë, ne besojmë se e ardhmja jonë është në familjen evropiane.

Andaj, ne shpallim synimin tonë për të marrë të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar anëtarësim të plotë në Bashkimin Evropian, sapo që të jetë e mundur, dhe për të zbatuar reformat e kërkuara për integrim evropian dhe euroatlantik.

Ne i shprehim mirënjohje Organizatës së Kombeve të Bashkuara për punën që ka bërë për të na ndihmuar në rimëkëmbjen dhe rindërtimin pas lufte dhe në ndërtimin e institucioneve të demokracisë.

Ne jemi të përkushtuar të punojmë në mënyrë konstruktive me Organizatën e Kombeve të Bashkuara, derisa ajo vazhdon punën e saj në periudhën në vijim.

Me pavarësinë vjen detyra e anëtarësisë së përgjegjshme në bashkësinë ndërkombëtare. Ne e pranojmë plotësisht këtë detyrë dhe do t'u përmbahemi parimeve të Kartës së Kombeve të Bashkuara, Aktit final të Helsinkit, akteve të tjera të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, obligimeve ligjore ndërkombëtare dhe parimeve të marrëdhënieve të mira ndërkombëtare që shënojnë marrëdhënie ndërmjet shteteve.

Kosova do të ketë kufijtë e saj ndërkombëtar, ashtu siç janë paraparë në Aneksin 8 të Planit të Ahtisarit, dhe do të respektojë plotësisht sovranitetin dhe integritetin territorial të gjithë fqinjëve tanë.

Kosova, po ashtu, do të përmbahet nga kërcënimi apo përdorimi i forcës në cilëndo mënyrë që është jokonsistente me qëllimet e Kombeve të Bashkuara.

Ne, nëpërmjet kësaj Deklarate marrim obligimet ndërkombëtare të Kosovës, përfshirë ato të arritura në emrin tonë nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë – UNMIK, si dhe obligimet e traktateve dhe obligimet e tjera të ish Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, ndaj të cilave obligohemi si ish pjesë konstituive, përfshirë Konventat e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike dhe konsullore.

Ne do të bashkëpunojmë plotësisht me Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish – Jugosllavinë.

Ne synojmë të kërkojmë anëtarësim në organizatat ndërkombëtare në të cilat Kosova do të synojë të kontribuojë për qëllimet e paqes dhe të stabilitetit ndërkombëtar.

Kosova zotohet për paqe dhe stabilitet në rajonin tonë dhe në Evropën Juglindore.

Pavarësia jonë e sjell në fund procesin e shpërbërjes së dhunshme të Jugosllavisë. Gjersa ky proces ka qenë i dhembshëm, ne do të punojmë pa pushim për t'i kontribuar një pajtimi që do të mundësonte Evropën Juglindore të shkojë përtej konflikteve të së kaluarës dhe të farkojë lidhje të reja rajonale të bashkëpunimit.

Për këtë arsye, do të punojmë së bashku me fqinjët tanë për ta avancuar të ardhmen tonë të përbashkët evropiane.

Ne shprehim në veçanti dëshirën tonë për të vendosur marrëdhënie të mira me të gjithë fqinjët tanë, përfshirë Republikën e Serbisë, me të cilën kemi marrëdhënie historike tregtare dhe shoqërore, të cilat synojmë t'i zhvillojmë në të ardhmen e afërt.

Ne do të vazhdojmë përpjekjet tona për t'iu kontribuar marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë në bashkëpunim me Republikën e Serbisë, duke promovuar pajtimin ndërmjet popujve tanë.

Ne konfirmojmë, në mënyrë të qartë, specifike dhe të përvokueshme se Kosova do të jetë ligjërish e obliguar të plotësojë dispozitat e përmbajtura në këtë Deklaratë, përfshirë këtu veçanërisht obligimet e saj nga Plani i Ahtisarit.

Në të gjitha këto çështje ne do të veprojmë në pajtueshmëri me parimet e së drejtës ndërkombëtare dhe rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, përfshirë Rezolutën 1244, viti 1999.

Ne shpallim publikisht se të gjitha shtetet kanë të drejtën të mbështesin këtë Deklaratë dhe u bëjmë apel të na ofrojnë përkrahjen dhe mbështetjen e tyre.

Faleminderit! Thank you very much!

(Duartrokitje frenetike)

KRYETARI I KUVENDIT, JAKUP KRASNIQI:

Ju faleminderit, zoti Kryeministër!

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se votimi do bëhet me votim elektronik, andaj ju propozoj që të procedojmë.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 109 deputetë.

A ka ndonjë deputet që nuk e ka kartelën me veti?

Nëse ndokush nuk ka kartelë, mund të votojë me ngritjen e dorës.

Ju pyes, a jeni që votimi të bëhet në mënyrë elektronike, apo me ngritjen e dorës.

(Nga salla: Votojmë me ngritje dore)

Kush është “për”? Faleminderit!

Ky ishte sqarim lidhur me mënyrën se si do të votojmë.

Kush është për Deklaratën, të cilën e lexoi Kryeministri i Kosovës?

Ju faleminderit!

A ka “kundër”? Nuk ka.

(Duartrokitje)

Konstatoj se me të gjitha votat “për” të deputetëve të pranishëm, deputetët e Kuvendit të Kosovës, sot, më 17 shkurt 2008, shprehën vullnetin e tyre dhe përmes tyre, edhe vullnetin e qytetarëve të Kosovës për Kosovën shtet të pavarur, sovran dhe demokratik.

(Duartrokitje)

Dhe, nga ky moment, ndërron pozicioni politik i Kosovës. Kosova është:

REPUBLIKË, SHTET I PAVARUR, DEMOKRATIK DHE SOVRAN

(Duartrokitje)

Urime Ju dhe të gjithë atyre që po na përcjellin!

(Duartrokitje)

KRYESUESI, XHAVIT HALITI:

Të nderuar deputetë, ju lus që t'i zini vendet për të vazhduar punën.

Në vazhdim pason nënshkrimi solemn i Deklaratës.

Ftoj Presidentin e Kosovës, Fatmir Sejdiu, të nënshkruajë Deklaratën e Pavarësisë!

Ftoj Kryetarin e Parlamentit dhe Kryeministrin e Kosovës, që të nënshkruajnë së bashku Deklaratën e Pavarësisë!

(Të ftuarit, nënshkruajnë Deklaratën)

(Duartrokitje)

KRYESUESI, IBRAHIM GASHI:

Ftoj anëtarët e Kryesisë, zotin Xhavit Haliti dhe zotin Sabri Hamiti, që ta nënshkruajnë Deklaratën e Pavarësisë.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj anëtarin e Kryesisë, zotin Eqrem Kryeziu, ta nënshkruajë Deklaratën.

(Vijon nënshkrimi)

KRYESUESI, XHAVIT HALITI:

Ftoj anëtarin e Kryesisë, zotin Ibrahim Gashi ta nënshkruaj Deklaratën.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj anëtarin e Kryesisë, Nexhat Daci, ta nënshkruaj Deklaratën.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj anëtarin e Kryesisë, Naim Maloku.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj anëtarin e Kryesisë, Xhezair Murati.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj anëtarin e Kryesisë, Slobodan Petroviq. Nuk është prezent!

Ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, Ramë Buja.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të Aleancës Kosova e Re, Ibrahim Makolli.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, Lulzim Zeneli.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ardian Gjini.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar “7+” Zylfi Merxha.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar SLS, Bojan Stojanoviq. Nuk është prezent!

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Adem Grabovci.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Adem Hajdaraj.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Adem Salihaj.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Agim Veliu.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Ahmet Isufi.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Ali Lajçi.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Alush Gashi.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputeten e Kuvendit të Kosovës, Anita Morina-Saraçi.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Armend Zemaj.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Arsim Bajrami.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Arsim Rexhepi.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Bahri Hyseni.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Bajram Kosumi.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Behgjet Pacolli.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Berat Luzha.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Berim Ramosaj.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputeten e Kuvendit të Kosovës, Besa Gaxherri.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Branislav Gërbiq. Nuk është prezent!

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Bujar Bukoshi.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputeten e Kuvendit të Kosovës, Donika Kadaj.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Dragisha Miriq. Nuk është prezent!

Ftoj deputeten e Kuvendit të Kosovës, Drita Kadriu.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputeten e Kuvendit të Kosovës, Drita Maliqi.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Driton Tali.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputeten e Kuvendit të Kosovës, Edita Tahiri.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputeten e Kuvendit të Kosovës, Elheme Hetemi.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Emrush Xhemajli.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Enis Kervan.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Enver Hoxhaj.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Esat Brajshori.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Etem Arifi.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Ethem Çeku.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Fatmir Limaj.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Fatmir Rexhepi.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputeten e Kuvendit të Kosovës, Fatmire Berisha.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Fehmi Mujota.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputeten e Kuvendit të Kosovës, Flora Brovina.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Gani Buçinca.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Gani Geci.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Gani Koci.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputeten e Kuvendit të Kosovës, Gjylnaze Syla.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputeten e Kuvendit të Kosovës, Hafize Hajdini.
(Vijon nënshkrimi)

KRYESUESI, IBRAHIM GASHI:

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Hajdin Abazi.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Hajredin Hyseni.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Hajredin Kuçi.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Haki Shatri.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Hestet Cakolli.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Hydajet Hyseni.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Ibrahim Selmanaj.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Ismet Beqiri.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputeten e Kuvendit të Kosovës, Kaçusha Jashari.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha.
(Vijon nënshkrimi)

KRYESUESI, XHAVIT HALITI:

Ftoj deputeten e Kuvendit të Kosovës, Kosara Nikoliq. Mungon!

Ftoj deputetin e Kuvendit Ljubisha Zhiviq. Mungon!

Ftoj deputeten e Kuvendit të Kosovës, Luljeta Shehu.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Lutfi Haziri.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Mahir Yagcilar.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Mark Krasniqi.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputeten e Kuvendit të Kosovës, Melihate Tërmkolli.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Memli Krasniqi.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Mihajlo Shqepanoviq. Mungon!

Ftoj deputeten e Kuvendit të Kosovës, Mimoza Ahmetaj.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Mursel Halili. Mungon!

Ftoj deputeten e Kuvendit të Kosovës, Mufera Shinik.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputeten e Kuvendit të Kosovës, Myrvete Pantina.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputeten e Kuvendit të Kosovës, Myzejene Selmani.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Naim Rrustemi.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Nait Hasani.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Naser Osmani.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Naser Rugova.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputeten e Kuvendit të Kosovës, Nekibe Kelmendi.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputeten e Kuvendit të Kosovës, Nerxhivane Dauti.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Numan Balić.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputeten e Kuvendit të Kosovës, Nurishahe Hulaj.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputeten e Kuvendit të Kosovës, Njomza Emini.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputeten e Kuvendit të Kosovës, Qamile Morina.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputeten e Kuvendit të Kosovës, Radmila Vujoviq. Mungon!

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Ramadan Avdiu.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Ramadan Gashi.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Ramë Manaj.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Rasim Selmanaj.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputeten e Kuvendit të Kosovës, Rita Hajzeraj.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Riza Smaka.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Rrustem Mustafa.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Sabit Rrahmani.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Sadik Idriz.
(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputeten e Kuvendit të Kosovës, Safete Hadërgjonaj.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputeten e Kuvendit të Kosovës, Sala Berisha-Shala.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputeten e Kuvendit të Kosovës, Sanije Aliaj.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputeten e Kuvendit të Kosovës, Selvije Halimi.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Skender Hyseni.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Slavisha Petković. Mungon!

Ftoj deputeten e Kuvendit të Kosovës, Suzan Novobërdaliu.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputeten e Kuvendit të Kosovës, Synavere Rysha.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Shkumbin Demalijaj.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputeten e Kuvendit të Kosovës, Shpresa Murati.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputeten e Kuvendit të Kosovës, Teuta Hadri.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputeten e Kuvendit të Kosovës, Vezira Emrush.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Vladimir Todorović. Mungon!

Ftoj deputeten e Kuvendit të Kosovës, Vlora Çitaku.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Xhevdet Neziraj.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Zafir Berisha.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputetin e Kuvendit të Kosovës, Zef Morina.

(Vijon nënshkrimi)

Ftoj deputeten e Kuvendit të Kosovës, Zylfije Hundozi.

(Vijon nënshkrimi)

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Konstatoj se kemi përmbushur obligimin tonë për ta nënshkruar të gjithë Deklaratën e Pavarësisë.

Ftoj Kryetarin e Parlamentit që ta rimerr udhëheqjen e Kuvendit.

(Duartrokitje)

KRYETARI I KUVENDIT, JAKUP KRASNIQI:

Të nderuar deputetë,

Tani vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

MIRATIMI I SIMBOLEVE SHTETËRORE TË KOSOVËS – TË FLAMURIT DHE TË STEMËS

Ju, të nderuar deputetë, para veti keni variantin e simboleve – të Flamurit dhe të Stemës.

Për ta shkurtuar procedurën, kalojmë menjëherë në votim.
Meqë u përcaktuam që votimi të bëhet me ngritjen e dorës, ju ftoj të votojmë.

Kush është “për”? Ju faleminderit!

(Duartrokitje)

(Me këtë rast në sallë sillet Flamuri dhe vihet në vendin e duhur)

(Duartrokitje)

Të nderuar deputetë,
Ky është Flamuri i shtetit më të ri në Evropë dhe në botë, i shtetit të Kosovës!
E gëzofshim të gjithë! Gëzuar!

(Duartrokitje)

Të nderuar deputetë,
Duke ju urrear edhe një herë Republikën e Kosovës, të pavarur dhe sovranë, dhe duke ju urrear për miratimin e Flamurit të Kosovës, seancën e sotme e shpall të mbyllur.

(Duartrokitje)

E përgatiti:

Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Republikës së Kosovës